



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1701, datë 20.10.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.10.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a, të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1651, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”;
2. Shkresa e AKEP nr. 1209 prot, datë 19.07.2011 “*Njoftim Vendimi nr. 1651, datë 18.07.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP*”;
3. Shkresa nr. 1207 prot, datë 19.07.2011 e AKEP drejtuar sipërmarrësve Neofone dhe Eagle Mobile “*Njoftim për seancë dëgjimore në selinë e AKEP*”;
4. Shkresa nr. 3569 prot, datë 7.10.2011 e Eagle Mobile sh.a “Marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur ndërmjet sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a dhe Abissnet sh.a” (AKEP: 1614 prot, datë 12.10.2011);
5. Shkresa nr. 109 prot, datë 12.10.2011 e Neofone sh.p.k “*Kërkesë për mbylljen e procedimit për ankimin administrativ me shkresën nr. 80 prot, datë 9.5.2011 të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011*” (AKEP: 1623 prot, datë 13.10.2011);
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R Ë N:

1. AKEP me anë të Vendimit nr. 1651, date 18.07.2011 të Këshillit Drejtues “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

“Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.;

Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a për fillimin e procedimit administrativ;

Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit”;

Për sa më sipër AKEP në vijim të procedimit administrativ me anë të shkresës nr. 1207 prot, datë 19.07.2011, “Njoftim për seancë dëgjimore në selinë e AKEP”, ka çmuar të thërrasë në një seancë dëgjimore sipërmarrësit Neofone dhe Eagle Mobile në selinë e AKEP më datë 21.07.2011 ora 11: 00;

2. Gjate seancës dëgjimore, të mbajtur në seline e AKEP morën pjesë sipërmarrësit Neofone sh.p.k, Eagle Mobile sh.a dhe përfaqësues nga AKEP, vihet re se:

Eagle Mobile konsideron se është në plotësimin e procedurave si në rrafshin kohor dhe në dokumentacion për të realizuar lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit me operatorin Neofone, dhe se me Neofone është rënë dakord që të mbyllen këto problematika, pavarësisht fillimit të procedimit administrativ me operatorin Neofone si dhe me operatorët e tjerë alternativë të cilët kanë sjellë dokumentacionin përkatës në zyrat tona dhe që janë konform standarteve.

Eagle Mobile shpreh bindjen se shumë shpejt do të nisim draft Mi-ne e operatorit Neofone. Megjithatë pretendon se operatori në fjalë është një operator i cili ka akses përmes Albtelecom por që nuk ka trafik, është një operator virtual në treg, ekziston vetëm me numrat test të tij.

Neofone prapsoi duke sqaruar se Eagle Mobile nuk mund të vlerësojë ne kete mnyre paparpakisht Neofone duke mos i dhënë mundësinë e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit midis tyre.

AKEP në kuadër të procedimit administrativ “*Fillimit të procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone shpk dhe Eagle Mobile sha*”, mbështetur në alternativën juridike të zgjidhjes me mirëkuptim midis palëve të mosmarrëveshjes në fjalë, ndodhur edhe në kushtet e një mosmarrëveshjeje të hapur si procedurë zgjidhjeje administrative në AKEP tashmë, kërkoi nga palët te vlerësojnë edhe njëherë mundësite juridike në terma ligjore, teknike dhe financiare që krijon oferta referenc e interkoneksionit e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a miratuar me VKD të AKEP nr. 1468, datë 23.12.2010 dhe nëse palët çmojnë dhe konsumojne problematikën e tyre, duke vlerësuar edhe njëherë kërkesë – ofertën për interkoneksion, dhe bëhet e mundur lidhja e marrëveshjes së interkoneksionit midis tyre, AKEP ne menyre te vazhdueshme të vihet në dijeni per cfaredo lloj rrethane te re te krijuar ne menyre qe vendimmarja perfundimtare per kete mosmarreveshje te gjeje te pasqyruar te gjithe retoriken e veprimeve kontraktuale tregtare.

Eagle Mobile, pas fjalës së AKEP theksoi se në vijim të këtij takimi të rëndësishëm, në ditët në vazhdim do të njoftohet operatori Neofone, për realizimin e një takimi te ardhshem për t’i dhënë fund problematikave dhe për të arritur në një marrëveshje interkoneksioni e cila do ti sherbeje dhe do të jetë në përfitim të të dy palëve. Eagle Mobile premtoi se per te gjitha keto, Autoriteti do te behet me dijeni qofte ne poste te shkruar elektronike apo edhe me shkresa formale.

AKEP pasi dëgjoi pretendimet e palëve, e vlerësoi të mbyllur këtë seancë dëgjimore duke shpresuar në ftesa per takim dhe negociata tregtare nga ana e tyre, pergjate

kesaj periudhe te shqyrtimit administrative nga ana e AKEP, duke kerkuar edhe njehere dijenine e c'do veprimi apo shkrese kembimi qe ka lidhje me objektin e mosmarrëveshjes dhe me këto pale.

3. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

I. Në lidhje me thelbin e kësaj mosmarrëveshje, i cili pasqyrohet si çështje e portabilitetit të numrit, rrugëzim të drejte të thirrjeve dhe teste të sukseshme, Autoriteti me shkresën nr. 728/2 prot, datë 10.06.2011 *“Sqarime mbi implementimin e portabilitetit të numrit”* i është drejtuar disa sipërmarrësve dhe konkretisht edhe Eagle Mobile sh.a , duke dhënë disa sqarime mbi detyrimet që ka secili operator i autorizuar nga AKEP për rrugëzimin e trafikut drejt numrave të bartur.

Qëllimi i këtyre sqarimeve ishte që procesi i portabilitetit të numrit të jetë i sukseshëm dhe objektivi kryesor i tij të jetë mbrojtja e interesave të përdoruesve të shërbimeve telefonike në mënyrë që përdoruesit që transferojnë numrin tek një operator tjetër të mos kenë probleme me thirrjet e marra (hyrëse).

Gjithashtu, AKEP në pikën dy të kësaj shkrese ka sqaruar sipërmarrësit në lidhje me ndryshimet e bëra në ofertën reference të operatorëve celular dhe rregullat për Albtelecom sh.a., bazuar në Vendimin nr.1560, datë 20.04.2011, dhe nr. 1581 datë 26.04.2011 të KD të AKEP, duke përcaktuar shprehimisht si më poshtë:

“Një operator celular ka detyrimin të mos lidhë marrëveshje interkoneksioni direkte me një operator dhe ose ka detyrimin t’a ndërpresë interkoneksionin direkt me këtë operator në rast se ky operator nuk kryen analizën dhe rrugëzimin e thirrjeve sipas metodës ACQ”.

II. Gjithashtu, AKEP me anë të shkresës nr. 728/24 prot, datë 13.07.2011 *“Mbi verifikimin e rrugëzimit të thirrjeve sipas metodës ACQ në disa sipërmarrës”*, i është drejtuar Eagle Mobile duke e bërë me dije mbi testimin e kryer nga AKEP në disa sipërmarrës duke verifikuar në këtë mënyrë se cilët prej tyre e kryejnë rrugëzimin e thirrjeve, ndër të cilët përfshihej edhe sipërmarrësi Neofone sh.p.k, dhe se cilët operatorë nuk e kryejnë rrugëzimin e thirrjeve sipas metodës ACQ.

III. AKEP, pas deklarimeve të këtyre palëve pjesëmarrëse në procedimin administrativ, në kuadër të bisedimeve gjate seancës dëgjimore të zhvilluar në selinë e AKEP, së fundmi me dt. 26.09.2011, bëhet me dije nëpërmjet postës elektronike zyrtare me lëndë *“Mbi firmosjen e MI-se me Neofone”* nga përfaqësuesit e sipërmarrësit Eagle Mobile drejtuar Neofone sh.p.k , së tanimë ka përfunduar testimi i pajisjeve dhe trafikut (voice & MNP) dhe se konfirmohet drafti i marrëveshjes midis Neofone dhe Eagle Mobile duke kërkuar firmosjen e tre kopjeve nga ana e Neofone sh.p.k. në mënyrë që Eagle Mobile të procedojë për lançimin e shërbimit në një datë të përcaktuar.

Gjithashtu, po nëpërmjet postës elektronike, me e-mailin e datës 27.09.2011 *“Mbi firmosjen e Mi-së me Neofone”* përfaqësuesit e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, i drejtohen Eagle Mobile dhe bëjnë me dije AKEP se shumë shpejt do të firmosen nga ana e tyre tre kopjet e Mi-ve të draftuara nga Eagle Mobile dhe të rëna dakord mes tyre, duke i dërguar të sigluara në adresën e Eagle Mobile.

IV. Për sa më sipër, vlerësohet se sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a, me ndërhyrjen administrative të AKEP, përfundimisht ka rënë dakord të interkonektojë rrjetin e tij me Neofone sh.p.k në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit dhe t'i sigurojnë njëra-tjetrs shërbimet dhe facilitet sipas kushteve të parashikuara në dokumentin e RIO-s së Eagle mobile.

Eagle Mobile me shkresën nr. 3569 prot, datë 7.10.2011 ka depozituar në AKEP “Marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur ndërmjet sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a dhe Neofone sh.p.k” (AKEP: 1614 prot, datë 12.10.2011).

Gjithashtu Neofone sh.p.k me anë të shkresës nr. 109 prot, datë 12.10.2011 “*Kërkesë për mbylljen e procedimit për ankimin administrativ me shkresën nr. 80 prot, datë 9.5.2011 të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011*” (AKEP: 1623 prot, datë 13.10.2011), drejtuar AKEP dhe për dijeni Eagle Mobile, pas nëshkrimit të MI-së me Eagle Mobile kërkon nga AKEP mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1651, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a;
2. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**